



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 2

Prishtinë, më 17.10. 2017, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Haxhi Shala, kryetar, Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë, Zoran Mosilović, zëvendëskryetar i dytë, Xhelal Sveçla, Drita Millaku, Ismet Beqiri, Fadil Beka, Fatmir Xhelili Blerim Kuçi dhe Bahrim Shabani, anëtarë.

Mungoi: Ramiz Kelmendi.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme: Flamur Sefaj, Ministër i Punëve të Brendshme, Naim Rexha, zv.Drejtor i Përgjithshëm i Policisë.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Drita Perezic-ICITAP, Leonora Berkani-ICITAP, Dhurata Kryeziu-OSBE, Agnesa Haxhiu-KDI, Arife Muji-QKSS.

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Haxhi Shala, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e komisionit e mbajtura me datë 09.10.2017 ;
3. Informim nga Ministri i Punëve të Brendshme, z.Flamur SEFAJ lidhur me prioritetet dhe sfidat e kësaj ministrie;
4. Të ndryshme.

Kryetari i Komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e komisionit e mbajtura me datë 10.10.2017.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Informim nga Ministri i Punëve të Brendshme, z.Flamur SEFAJ lidhur me prioritetet dhe sfidat e kësaj ministrie.

Kryetari, fillimisht uroi për detyrën e re Ministrin e Punëve të Brendshme, duke theksuar që ky takim ka për qëllim njoftimin mes Ministrin dhe anëtarëve të Komisionit si dhe për tu njohur me objektivat, sfidat dhe prioritetet e Ministrisë. Tutje fjalën ua kaloi anëtarëve të Komisionit për tu prezantuar.

Rexhep Selimi, thekso që aspekti i mbikëqyrjes parlamentare të sektorit të sigurisë është shuam i rëndësishëm dhe do të ushtrohet një mbikëqyrje e rrept për institucionet e sigurisë dhe do të vazhdohet praktika nga legjislatura e kaluar.

Zoran Mosilović, përshëndeti të pranishmit duke theksuar që nga Ministri pret që kërkesat që do të bëhen nga ana e tij për komunitetin serb, për plotësimin e ligjeve, për rrethanat e krijuara të merren parasysh nga ana e tij.

Fatmir Xhelili, theksoi që resori i punëve të brendshme ka një barrë më të rëndë, pasi ka përgjegjësinë e sigurisë së qytetarëve, pronës, lirisë, për krijimin e hapësirës për zbatimin e rendit dhe ligjit. Tutje theksoi që Komisioni do të jetë i kujdesshëm për të ofruar përkrahjen ministrisë për të gjitha çështjet ligjore, zhvilluese dhe implimentuese, në drejtim të zbatimit të ligjit, por duke qenë edhe kritikues si Komision, kur kjo është e arsyeshme. Gjithashtu shtoi që ministria duhet të jetë e kujdesshme në zbatimin e obligimeve që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asocimit dhe Programi kombëtar për MSA-në, duke kërkuar që këto çështje të jenë prioritet.

Fadil Beka, theksoi që do të jetë bashkëpunues në punën e Komisionit.

Drita Millaku, vlerësoi që Komisioni që mbikëqyr sektorin e një rëndësie të veçantë, duke theksuar që do të jepet kontribut në këtë drejtim.

Xhelal Sveçla, fillimisht uroi Ministrin me pritshmërinë që do të filloj reformën e thellë në resorin që udhëheq. Duke shtuar që opinioni i gjerë e di që ka pasur skandale të një pas njëshme dhe kjo është një nevojë për reformimin e politikave, kuadrove në këtë sektor.

Ismet Beqiri, konsideroi që sektori i sigurisë është i një rëndësie të veçantë dhe ofroi mbështetjen në kuadër të Komisionit përgjatë kësaj legjislature dhe uroi suksese të mëtutjeshme.

Bahrim Shabani, theksoi që përfaqëson komunitetin boshnjak dhe theksoi që bashkë do të punohet për të mirën e gjithë komuniteteve.

Blerim Kuçi, e vlerësoi si përparësi faktin që Ministri nuk është figurë politike e njohur dhe s'kjo mund të jetë si përparësi, duke theksuar që do të ketë mbikëqyrje dhe bashkëpunim.

Kryetari, fjalën ia kaloi Ministrit të Punëve të Brendshme, për të njoftuar Komisionin me Prioritete, objektivat dhe sfidat e Ministrisë dhe qasjen e tij ndaj aktualitetit.

Flamur Sefaj, Ministër i Punëve të Brendshme, fillimisht theksoi që misioni i ministrisë është për zbatimin e ligjit dhe ruajtjen e sigurisë të njerëzve dhe pronës në gjithë territorin e Kosovës. Makro prioritetet kanë të bëjnë me punën e Ministrisë së Brendshme dhe janë prioritetet nacionale siç është lufta ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit, lufta kundër terrorizmit dhe kontrolli i radikalizmit të çdo lloji dhe luftimi me dhunën, punën e madhe që duhet bërë për anëtarësim në organe dhe organizata ndërkombëtare, duke theksuar që këto janë caqet me rëndësi nacionale.

Tutje theksi që problem tjetër shumë i madh dhe që lidhet me jetën e njerëzve në Kosovë ka të bëjë me aksidentet rrugore. Ai bëri të ditur se janë duke punuar me ministrinë dhe institucionet tjera për përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe elementet e tjera, si kontrollimi i numrit të pjesëtarëve të policisë në trafik. Gjithashtu një problematik tjetër për të cilën do të punohet është largimi i lypësve të qëndrueshëm nga rrugët e qendrave urbane dhe jo urbane. Gjithashtu prioritet tjetër i cili është kërkuar edhe nga kryeministri Haradinaj që ka iniciuar që të punohet në luftën kundër drogës në ambientet shkollore, pasi mosha e konsumuesve të drogave është ulur shumë në Kosovë dhe sipas tij do të hidhen hapat e duhura në këtë aspekt. Aspekte të tjera në fushën e mikrokrimit, siç janë vjedhjet, akumulim i krimit në lagje, aspekte të cilat duhen trajtuar dhe të merren masa. Gjithashtu mosha e Policisë së Kosovës, aktualisht nuk e pasqyron moshën e popullatës dhe për këtë arsye kërkoi bashkëpunimin e Komisionit, që Projektligji për pensionimin e pjesëtarëve të Policisë pasi të procedohet në Kuvend.

Duke iu përgjigjur çështjes së ngritur nga z.Xhelili, theksoi që do të punohet në këtë drejtim, duke shtuar që ka pasur pak ngecje në përpilimin e disa tabelave, të cilat janë punë teknike por që kërkon punë. Aspekt tjetër janë edhe pikat e përbashkët(menaxhimi i integruar i kufijve) dhe është duke u punuar në këtë drejtim dhe që edhe personalisht do të angazhohet duke shpresuar në zbatimin praktik të ligjeve.

Kryetari, lidhur me procedimin e projektligjeve të cilat janë paraparë në strategjinë legislative të Qeverisë, shtroi pyeten. A do të jetë ministria e gatshme që ti procedoj në Kuvend ashtu siç janë paraparë?

Flamur Sefaj, Ministër i Punëve të Brendshme, lidhur me këtë çështje, theksoi që projektligjet janë proceduar në Ministrinë e Integritetit dhe të financave, duke shpresuar që sipas afatit kohor të procedohen.

Rexhep Selimi, theksoi që shpreson që Qeveria të ketë vullnetin të procedoj projektligje dhe se Komisioni është i gatshëm të punoj. Tutje kërkoi që të ofrohet informacion në takimet e radhës, lidhur me mbarrëvajtjen e procesit të gradimit në nivele të larta në kuadër të policisë gjatë kohës kur nuk ka pasur mbikëqyrje parlamentare, duke shtuar se mbikëqyrja parlamentare do të vazhdoj.

Flamur Sefaj, Ministër i Punëve të Brendshme, në përgjigjeje të pyetjes së z.Selimi, theksoi që do të ketë të dhënat në takimin e radhës sa i përket çështjes së gradimeve në kuadër të policisë.

Drita Millaku, shtroi çështjen e menaxhmentit në administratë, si në nivelin qendror edhe ë drejtoritë regjionale, e cila udhëhiqet nga stafi i uniformuar. Tutje shtroi pyetjen: Çfarë ka në planë Ministri të bëjë me këtë çështje, përderisa zyrtarët e uniformuar udhëheqin departamente, njësi etj? A ka plan që administrata të udhëhiqet nga stafi civil, apo do të vazhdoj udhëhiqet nga stafi i uniformuar?

Ndërsa sa i përket aksidenteve të shumta në rrugë, që u theksua si problem në rritje. Cilat janë shkaqet që ndodhin aksidente të shumta?

Flamur Sefaj, Ministër i Punëve të Brendshme, në përgjigjeje të znj.Millaku, theksoi që administrata civile dhe ajo e uniformuar, i nënshtrohen dy ligjeve, Ligjit të policisë dhe Ligjit për shërbyesit civil, por që kjo çështje është në diskutim e sipër, dhe është duke u shikuar mundësia bartjes së shërbyesve civil në kuadër të policisë në Ligjin e Policisë. Ndërsa s ai përket shkaqeve të aksidenteve, theksoi se janë rrugët, kultura, sinjalistika, mjetet e sofistikuar të policisë. Prandaj vlerësoi të nevojshëm një angazhim të përgjithshëm.

Blerim Kuçi, shtroi çështjen nëse puna e Ministrisë në bazë së cilit dokument do të bazohet. A ka strategji, plan pune për të arritur objektivat e përcaktuara? Duke vlerësuar të nevojshme posedimin e këtyre dokumenteve. Tutje theksoi dhe kërkoi që nga Ministri i Punëve të Brendshme të mos ketë tolerime në raport me ministrinë e tjera, pasi Ministria e Punëve të Brendshme është një filtër për të gjitha fushat tjera.

Flamur Sefaj, Ministër i Punëve të Brendshme, në përgjigjeje të z.Kuci, theksoi që në procedurë duke u hartuar janë dymbëdhjetë strategji gjithashtu është dorëzuar programi për Ministrinë dhe agjencitë në kuadër të saj, ndërsa të gjitha strategjitë do të inkorporohen në strategjinë nacionale të sigurisë.

Xhelal Svecla, theksoi se nga prezantimi i objektivave nga Ministri ndjehet skeptik, për shkak se me problemet që përballen vendi janë më të mëdha, nga ato që u deklaruan nga Ministri si mikrokrim duke vlerësuar se resori i punëve të brendshme ka nevojë për reformim, kontroll të

brendshëm. Gjithashtu kërkoi që të dorëzohet organografi i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe agjencitë në kuadër të Ministrisë me qëllim të mbikëqyrjes më të mirë, po ashtu këshilloi që të hulumtohet më shumë për përfshirjen e zyrtarëve të Ministrisë në krim dhe korrupsion, duke ditur që Ministria është shtylla e parë. Në vazhdim kërkoi që të dërgohet një listë e zyrtarëve të cilët kanë aktakuzë dhe masat e ndërmarra ndaj tyre, edhe pse ka tregues që ka transferimi nga njëra pozitë në tjetrën si masa ndëshkimore, ndërsa masat e ndërmarra nga ministria për zyrtarët që shkelin ligjin duhet të jenë shembull për gjithë shoqërinë. Tutje përmendi skandalet e pazbuluara, siç ka qenë rasti me dhomat e sigurisë dhe tenderët e ndryshme, prandaj kërkoi që të fokusohen në këto çështje me qëllim të rritjes së besimit të qytetarëve ndaj Ministrisë. Gjithashtu theksoi nevojën e rregullimit të çështjes së pensioneve për policinë dhe kushteve të punës në çdo agjencion në kuadër të Ministrisë.

Flamur Sefaj, Ministër i Punëve të Brendshme, në përgjigjeje të çështjeve të ngritura nga z.Svecla, theksoi që do të jetë zbatues i ligjit ndërsa dokumentet e kërkuara do të jenë transparente.

Xhelal Sveçla, shtoi se nuk po kërkohet shkelja e ligjit por zbatimi i ligjit ndaj shkelësve të ligjit.

Drita Millaku, shtroi çështjen e dhomave të sigurisë dhe vjedhjeve të ndryshme të qytetarëve dhe deri më tani nuk janë pasqyruar këto raste, gjithashtu shqetësim i qytetarëve janë edhe dënimet e mëdha në komunikacion. Për këtë shtroi pyetjen për Ministrin: A do të jenë prioritet këto çështje gjatë mandatit si Ministër.

Flamur Sefaj, Ministër i Punëve të Brendshme, sa i përket çështjes së trafikut, theksoi se është fushë shumë dimensionale dhe nuk rregullohet vetëm me gjoba, ndërsa theksi që ligji do të jetë i barabartë për të gjithë.

Zoran Mojsilović, theksoi që pret që pyetja parlamentare e bërë nga ai të marrë përgjigjeje dhe pret bashkëpunim. Gjithashtu theksoi që nëse do të punon Ministri në drejtimin duhur do të ketë edhe përkrahjen edhe të komunitetit serb, duke shpresuar në bashkëpunimin dhe përvojat pozitive .

Flamur Sefaj, Ministër i Punëve të Brendshme, në përgjigjeje të z.Mosilović, theksoi që ka marrë pyetjen parlamentare dhe shumë shpejt do të jap përgjigjeje për çështjen ngritur. Ndërsa s ai përket caqeve të përcaktuara theksoi që do të bëhen sipas ligjit dhe parimit të barabartë para ligjit për të gjithë qytetarët. Falënderoi gjithë komisioni dhe ftoi për bashkëpunim të mëtutjeshëm.

Kryetari, falënderoi për prezencën në Komision, duke vlerësuar si frytdhënës këtë takim, pasi dolën çështjet se çfarë duhet bërë dhe mbikëqyrur, pasi siguria është për të gjithë dhe mbi të gjitha.

4. Të ndryshme.

Kryetari, lidhur me planin e punës për tre muji e fundit të vitit 2017, ftoi anëtarët të japin propozime shpesh, pasi drafti i parë është shpërndarë. I njëjti pasi të plotësohet në mbledhjen e radhës vendoset në rend të ditës për miratim.

Rexhep Selimi, lidhur me draft planin dhe projektligjet e parapara nga Qeveria, kërkoi të jepet një njoftim lidhur me Projektligjin për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura, i cili është paraprë të vije në muajin dhjetor. A është njoftuar kryetari i Komisionit për këtë projektligj, a do të ketë ndryshime kushtetuese apo vetëm projektligji? Për këtë arsye kërkoi disa informacione se deri ku kanë shkuar procedurat lidhur me këtë projektligj, gjithashtu theksoi se është gatishmëria e Komisionit për të punuar për të gjitha projektligjet që do të procedohen.

Fatmir Xhelili, lidhur me Projektligjin për pensionimin e pjesëtarëve të policisë, kërkoi sqarim nga administrata nëse është planifikuar nga Qeveria të sillen në Kuvend në muajin nëntor, pasi nuk do të kishte kuptim të trajtohet para se të aprovohet ligji për buxhet.

Shënim: Administrata e Komisionit sqaroi që të gjitha projektligjet e renditura në plan të punës janë sipas strategjisë legjislative të Qeverisë dhe sipas planifikimeve të tyre.

Kryetari, lidhur me kërkesën për sqarim nga z.Selimim, theksoi se nuk ka informacion por në mbledhjen e radhës do të ftohet në Komision Ministri i FSK-së.

Xhelal Svecla, propozoi që të përfshihet në planin e punës, që gjatë muajit tetor të bëhet një vizitë punë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (shkollën e policisë).

Fatmir Xhelili, propozoi që në kuadër të planit të punës, të përfshihet edhe raportimi në çdo tre muaj nga resor të caktuar dhe më së paku dy herë në vit raportim nga ministrat e linjës, për zbatimin e planit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit.

PËRFUNDIM

Kryetari konstatoi që Komisioni është dakord që në mbledhjen e radhës së Komisionit, të ftohet në takim njoftues me Komisionin Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, i shoqëruar nga Komandanti i FSK-së.

Kryetari, me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Haxhi Shala